REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E MBIKËQYRJES DHE KONTROLLIT
DREJTORIA E TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE DHE TREGJEVE

NJOFTIM

"PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE VENDORE BRENDA AFATIT TË PËRCAKTUAR DHE PARALAJMËRIMIN PËR MARRJEN E MASAVE SHTRËNGUESE"

Bashkia Elbasan njofton të gjithë kryefamiljarët, pronarë apo përdorues të njësive të banimit në territorin e Bashkisë Elbasan, të cilët kanë detyrime të papaguara për:
- Taksat mbi pasurinë e paluajtshme;
- Tarifën e pastrimit;
- Tarifën e gjelbërimit;
- Tarifën e ndriçimit;
-Tarifën për mirëmbajtjen e infrastrukturës;
-Tarifën për mirëmbajtjen e rrjetit kullues ujitës.

Kryefamiljarët të cilët nuk kanë kontratë aktive me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Elbasan, duhet të paraqiten pranë zyrave të rajoneve apo njësive administrative përkatëse të Bashkisë Elbasan për të verifikuar dhe shlyer detyrimet e tyre.

Afati përfundimtar për shlyerjen vullnetare të të gjitha detyrimeve është data 30 nëntor 2026*. Theksojmë se, pagesa e taksave dhe tarifave vendore është detyrim ligjor për çdo kryefamiljar dhe se nuk do të ketë tolerime për mospërmbushjen e këtyre detyrimeve.*

Pas këtij afati, ndaj të gjithë debitorëve që nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre do të fillojnë procedurat ligjore të mbledhjes me forcë të detyrimeve, përfshirë bllokimin e llogarive bankare dhe masa të tjera të ekzekutimit të detyrueshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bashkia Elbasan fton qytetarët të kryejnë pagesën e detyrimeve vendore brenda afatit të mësipërm, përpara nisjes së procedurave ligjore për mbledhjen me forcë të detyrimeve të papaguara.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!